

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Mbledhja e Radhes e Këshillit Bashkiak Muaji Shkurt mbajtur sot me datë 27/02/2026 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 12 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Brunilda Ballolli, Kujtim Brahimi, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Idri Kokla.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Merr pjese ne mbledhje nen/ Kryetari i Bashkise, z.Tajar Bici

Në zbatim të **Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak**; “Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit”; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjesit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

E.Zani: Pershendetje, kemi nje propozim per te futur ne rend dite nje material shtese:

“Per disa ndryshime ne nivelin e pagave e shperblimeve, te punonjesve e personave, te emeruar ose te zgjedhur te bashkise Gramsh, per vitin 2026 te Vendimit nr.86 date 27.12.2024 “Per miratimin e numrit maksimal te punonjesve dhe nivelin e pagave e shperblimeve, te punonjesve e personave, te emeruar ose te zgjedhur te bashkise Gramsh”.

F.Cekrezi: Se pari cdo fundvit, dhe kur struktura nuk paraqet ndryshime duhet ti paraqitet keshillit, eshte detyrim funksional. Kurumi per material jashte rendit te dites nuk plotesohet, duhen 14 anetare te pranishem.

L.Zogu: Struktura nuk ka patur ndryshime ndaj nuk e sollem.

F.Cekrezi: Eshte procedure standarte, struktura dihet te kaloje ne votebesim.

E.Zani: Hedhim ne votim pikat e rendit te dites? (pa materialin shtese)

***Miratohet rendi ditës me 12 Vota PRO.**

Nuk ka Vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 22 25 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 1

1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Janar 2026 (fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 12 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Brunilda Ballolli, Kujtim Brahimi, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Idri Kokla.

Pergj.sek.ndh.ek.: Nga totali i muajit te kaluar kemi rene me nje familje, kane dale 3 familje dhe kemi 1 hyrje. Nga 47 , kete muaj kemi 46 familje per perfitim te gjeneruara nga sistemi elektronik.

E.Zani: Votojme?

***Miratohet pika 1 e rendit te ditës me 12 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Arnilda Dakare



Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 22272 E-mail: bashkiagramsh@gmail.com

Luljeta Dollani *Visarion Bici*

Çështja 2

2-Për përditësimin e të dhënave të disa pasurive të paluajtshme të transferuara në klasa, kalimin e tyre në pronësi, si dhe transferimin rishtaz në pronësi të disa pasurive të tjera të kategorisë “tokë bujqësore” (për zhvillim ekonomik, dhënie me qera) , sipas listave bashkëngjitur.

Në mbledhje marrin pjesë 12 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Brunilda Ballolli, Kujtim Brahimi, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Idri Kokla.

Q.Kullolli: Behet fjale për 82 pasuri që ne i kemi kaluar me pare, ne i kaluam në përdorim dhe tani do i kalojmë në pronësi, duke i kaluar në pronësi kërkohej përse do i përdorim, ne do ti përdorim për ti dhënë me qera.

K.Brahimi: Në skemë asnjë hartë të dimë se ku ndodhen, a janë në pronësi të shtetit dhe kalojmë në pronësi të bashkisë? A do lindin ndonjë konflikt?

Q.Kullolli: Këto janë prona shtetërore, informacionin e keni të lista se ku janë zonat kadastrale. Të gjitha pasuritë që i kemi cuar për transferim janë pajisur me plan rilevimi të përcaktuar me kufij.

E.Zani: Hartat duhet ti kishit paraqitur me pare për qartësi.

A.Dakare: Problemi është mos janë zënë këto toka dhe lindin konfliktet

Q.Kullolli: Nëse e ka rastë të tilla, ne nuk do ti hapim problem qytetarit, do ti hapet rruga që ti jepet me qera, pra ai do të ketë prioritet.

K.Brahimi: Komisioni i kthimit të pronave, a ka baze ligjore që duhet tja njohesh të drejtën pronareve

Q.Kullolli: Në dimë që kemi një listë me VKM që ka prona të bllokuara.

V.Bici: Besoj që këto vijnë nga kërkesat e qytetarëve.

Q.Kullolli: Indicia vjen nga qytetaret.

E.Shahini: Komisioni i Kthimit të Pronave ekziston, ne po flasim për prona që mund të certifikohet pronar bashkia, që me vonë ti hapet rruga kontratave të qerave.

D.Hazizaj: A është bërë inventarizimi dhe kontrolli i gjendjes fizike të këtyre?

T.Bici: Kushdo që pretendon se e ka zënë token, nuk kanë akses ligjor mbi të, ku në rastin konkret bashkia nuk është pronar, mbasi bashkia të bëhet pronar, hap pas hapi vijnë e procedurat për dhënie me qera. Ligji për paketën e Maleve u jep përparësi personave që kanë kohë që e posedojnë pronën për kohë të gjatë, pra do të jepet përparësi.

V.Bici: Ku është bashkia jone me Paketën e maleve?

T.Bici: Janë 16 zona për tu dërguar ministrisë, jemi në fazën përfundimtare të dokumentacionit. Ne kemi rreth 90 aplikime që janë bërë në bashkinë tonë, ne kishim menduar 10 zona, Ministria na sugjeron edhe 6 zona të tjera.

E.Zani: Votojmë?

***Miratohet pika 2 e rendit të ditës me 12 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

**Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini**



Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Çështja 3

3-Për miratimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2025 .

Në mbledhje marrin pjesë 12 këshilltarë: Enis Zani, Fatbardh Cekrezi, Dalip Hazizaj, Greta Lena, Luljeta Dollani, Brunilda Gjevori, Brunilda Ballolli, Kujtim Brahimi, Visarion Bici, Ardiana Hasa, Arnilda Dakare, Idri Kokla.

E.Hysa: Lexon relacionin që u është paraqitur këshilltareve, citon shifrat .

K.Brahimi: Them të bëhet pak investim në qytet, të shtohen lulishtet, të rregullohen rruget, edhe shkallët në lagjen Llapushaj, plus ka mbi 70 dite që skemi dritë (të pjesa e shkalleve flitet). Të rregullohet njëherë qyteti që të vemi deri në fshat, të rregullohen tortuaret, të bëhen kanalizimet (e ngre si shqetësim të madh këto pjesë).

V.Bici: Kam mbi 3 vjet që kërkoj të rregullohet catia e shkollës në Lenie.

F.Cekrezi: Nga të ardhurat e trashëguara sa është parashikuar për detyrimet e prapambetura, shpenzimet operative ku qëndrojnë? Lidhur me rikonstruksionin e rrugës ish uzina e baterive, në kemi kaluar njëherë të njëjtin projekt, pse ka ardhur serisht se mesa di ishte me grant atëherë?

T.Bici: Lidhur me shifrë përgjigjet drejtori, në kemi menduar të rregullojmë shkollën dhe ambulancën në prrenjas, është shumë e nevojshme për ata njëzë që jetojnë atje, ashtu edhe në Skenderbegas për shkollën që është në shi, edhe shkolla në Lenie është objekt diskutimi për tu rregulluar. Çështja e ujërave të zeza në qytet gjithashtu duhet parë patjetër.

E.Zani: Votojmë?

***Miratohet pika 3 e rendit të ditës me 12 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk Ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Gramsh, më 27 /02 /2026

LISTË PREZENCË E KËSHILLTARËVE BASHKIAK
Mbledhja e Rradhes e Këshillit Bashkiak për Muajin SHKURT 2026

EMER MBIEMER	27 SHKURT 2026	EMER MBIEMER	FIRMA
1- ENIS ZANI	27.02.2026	Enis Zani	
2- VALBONA VERUSHI			
3- LULJETA DOLLANI	27.02.2026	Luljeta Dollani	
4- KODHEL CALA			
5- GRETA LENA	27.02.2026	Greta Lena	
6- VISARION BICI	27.02.2026	Visarion Bici	
7- ARDIANA HASA	27.02.2026	Ardiana Hasa	
8- ALKETA BICI			
9- RAMAZAN BRAHO			
10- EDMOND GURI			
11- ERALD ÇARÇIU			
12- IDRI KOKLA	27.02.2026	Idri Kokla	
13- ERISA ZOGU			
14- KUJTIM BRAHIMI	27.02.2026	Kujtim Brahimi	
15- MARSELA IBRO			
16- ALFRIDA SHAHINI			
17- DALIP HAZIZAJ	27.02.2026	Dalip Hazizaj	
18- ARNILDA DAKARE	27.02.2026	Arnilda Dakare	
19- BRUNILDA BALLOLLI	27.02.2026	Brunilda Ballolli	
20- FATBARDH ÇEKREZI	27.02.2026	Fatbardh Çekrezi	
21- BRUNILDA GJEVORI	27.02.2026	Brunilda Gjevori	

SEKRETARI I KËSHILLIT
XHULIA GJINI